



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izbornii Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.550/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi, dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lulzim Gacaferi, nga Departamenti i Mbrojtjes së Votës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Junik, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet si e pasafatshme** ankesa e Lulzim Gacaferi, nga Departamenti i Mbrojtjes së Votës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Junik, me shenjën ZL.Anr.550/2017 e datës 30.10.2017, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 22.10.2017.

## A r s y e t i m

PZAP, më datë 30.10.2017, ka pranuar një ankesë përmes postes nga Lulzim Gacaferi, nga Departamenti i Mbrojtjes së Votës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 22.10.2017 në vendvotimin 3101c01R, është nxjerrë nga dhoma një fletëvotim jashtë dhe në kutinë e votimit është futur një fletëvotim fallco. Më tej thekson se pas mbylljes së vendvotimit gjatë numërimit është gjetur një fletëvotim fallco dhe po ashtu në atë kuti pas numërimit është konstatuar se aty mungon një fletëvotim. Po ashtu parashtruesi i ankesës thekson se pas ndërprerjes së procesit me urdhër të prokurorit, dhe rreth orës 00:00 komisioneri, mbikëqyrësi i kutisë ka dal nga vendvotimi dhe pas një kohe është kthyer aty me fletëvotim, dhe se prokurori mendon se është në rregull.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e pasafatshme.**

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit, sipas nenit 119 të LZP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 5.3 i Rregullës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa, e njëjta është dorëzuar në postë, nga parashtruesi i ankesës me datë 24.06.2017, ndërsa në PZAP e njëjta është pranuar me datën 30.10.2017. Nga përmbajtja e

ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në ankesën ZL.Anr.550/2017 të datës 30.10.2017, ndërlihet me parregullsitë gjatë procesit të votimit, për ditën e votimit të datës 22.10.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar në postë, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 23.10.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka parashtruar në postë me datë 24.10.2017 dhe është pranuar nga PZAP me datën 30.10.2017, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.3, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 5 par. 5.3, neni 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.550/2017 më datën 31.10.2017



**Kryesuesi i Panelit**

Hasan Shala

**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.